



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural

Ministry of Agriculture, Forestry and Rural Development

Ministartsvo Poljoprivrede, Šumarstva i Ruralnog Razvoja

Komuna e Vushtrrisë

Municipality of Vushtrri

Opština Vučitrn

Prishtinë, 15.11.2022

Duke u bazuar në nenet 8 të Marrëveshjes së Mirëkuptimit baze për financimin e Projektit të Ujitjes për vitin 2022 palët nënshkruese lidhin këtë:

ANEKS MARRËVESHJE E MIRËKUPTIMIT PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT PËR UJITJE PËR KOMUNËN E VUSHTRRISË

Palët nënshkruese

1. Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural e përfaqësuar nga Ministri (në tekstin e mëtejme Ministria);
dhe
2. Komuna e Vushtrrisë e përfaqësuar nga Kryetari i Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna

Neni 1 Qëllimi

Qëllimi i kësaj Aneks Marrëveshjeje të Mirëkuptimit është ndryshimi dhe plotësimi i Marrëveshjes bazë të protokolluar me Nr.2399 të datës 04.07.2022 për rregullimin/përcaktimin e afatit të zbatimit të Projektit "Përmirësimi i infrastrukturës së sistemit të ujitjes në fshatrat e rrethit të Samadrexhës, Komuna e Vushtrrisë, fshati Samadrexhë" – Tipi i kanalit të mbyllur.

Neni 2 Afati

1. Afati i zbatimit të projektit nga neni 1 i kësaj Aneks marrëveshje ndërlidhet me zbatimin e kontratës së nënshkruar ndërmjet MBPZHR dhe operatorit ekonomik.
2. Realizimi i obligimeve në raport me zbatimin e projektit nga neni 1 i kësaj marrëveshje fillon së zbatuari brenda mundësive të lejuara buxhetore të përcaktuara për vitin 2022 dhe 2023.

Neni 3 Te drejtat dhe detyrimet

Të drejtat dhe detyrimet tjera të përcaktuara në Marrëveshjen baze të datës 04.07.2022 mbeten të pa ndryshuara.

Neni 4
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast kontesteve eventuale lidhur me dispozitat e kësaj aneks marrëveshje mirëkuptimi, palët do ti zgjidhin me marrëveshje, nëse kjo nuk mund të arrihet kontesti do të zgjidhët në Gjykatën kompetente në Prishtinë.

Neni 5
Kopje

Kjo Aneks Marrëveshje është hartuar në dy (2) kopje origjinale, ku secila palë nënshkruese merr nga një (1) kopje.

Neni 6
Hyrja në fuqi

Kjo Aneks Marrëveshje hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga palët nënshkruese.

Faton PEÇI

Ministër i MBPZHR-së



Ferit IDRIZI

Kryetar i Komunës së Vushtrrisë

